



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:242799

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05709428

KPPP.nr. 1853/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.T “A-Com”, me numër unik identifikues 810348814 dhe me seli në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Asdren Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Trepça” Sh.A., me numër unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, p.nr., duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 260/23, i lejuar me datë 24.10.2023, nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 20.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” Sh.A., me numër unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 260/23, i lejuar me datë 24.10.2023, nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 260/23, i lejuar me datë 24.10.2023, nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. 13/2023, e datës 23.08.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 260/23, të datës 24.10.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 33,748.00, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data e kalimit për pagesë, data 23.09.2023, e deri në përmbushjen definitive, si dhe

shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është marr urdhri përbarues nuk është i përshtatshëm për përbarim sepse në faturë nuk është e cekur koha e përmbushjes së detyrimit ashtu siç parashihet me nenin 27.1 të LPP-së. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin përbarimor.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor nuk është e përshtatshme për përbarim nuk qëndrojnë, për faktin se fatura përmban datën e pagesës, e cila datë është data 23.08.2023. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se përbaruesi privat ka lejuar urdhrin përbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 13/2023, e datës 23.08.2023, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga

ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar dhe vulosur nga ana e debitorit, dhe rrjedhimisht debitori ka qenë në dijeni për përmbajtjen e faturës dhe lartësin e detyrimit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1853/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.